

Broshurë teknike

# DUROCRET-DECO

## Shtresë dekorative mikroçimentoje për mure

### Përshkrimi

DUROCRET-DECO është një llaç i parapërzier me bazë çimentoje i modifikuar me polimer dhe i përforcuar me fibra i cili nuk përmban përbërës korrozivë, dhe që është i përshtatshëm për përdorim në ambiente të brendshme dhe të jashtme, duke ofruar:

- Rezistencë ndaj gërryerjes.
- Ngjitje shumë të mirë me nënshtresën.
- Papërshkueshmëri nga uji.
- Resultat të veçantë estetik.

Klasifikohet si llaç PCC R2 për riparime betoni, sipas EN 1504-3.

### Fushat e përdorimit

DUROCRET-DECO përdoret si llaç çimentoje në shumë raste, si në shkallë, dysheme, mure dhe për struktura të veçanta si shtrate inkaso, artikuj sanitarë inkaso (lavomane, dushe, etj). Mund të përdoret brënda dhe jashtë, në shtëpi, hotele dhe në çfarëdo rasti ku kërkohet një estetikë e veçantë (p.sh. aritekturë cikladike).

### Të dhënat teknike

|   |   |
|---|---|
| Trajta:                                 | pluhur çimentoje  |
| Ngjyrat:                                | e bardhë, gri, gri e lehtë, me mjaft më shumë të prodhuara me pigmentet ISOMAT DECO-COLOR |
| Jetëgjatësia në enë:                    | 2 orë në +20°C  |
| Kërkesa e ujit:                         | 5.50 l / thes 25 kg   |
| Densiteti i volumit të llaçit të thatë: | 1.45 ± 0.10 kg/litër  |
| Densiteti i volumit të llaçit të njomë: | 1.80 ± 0.10 kg/litër  |
| Rezistenca në shtypje:                  | ≥ 22.0 N/mm <sup>2</sup>  |
| Rezistenca në përkulje:                 | ≥ 6.0 N/mm <sup>2</sup>   |
| Përmbajtja në kloride:                  | 0,00%   |
| Ngjitje:                                | ≥ 1.3 N/mm <sup>2</sup>   |
| Ngjitje pas 50 cikle ngrirje-shkrirje:  | ≥ 1.2 N/mm <sup>2</sup>   |

|                          |  |
|--------------------------|--|
| Trashësia e zbatimit:    | 2-10 mm për shtresë                        |
| Thithja kapilare e ujit: | 0.34 kg·m <sup>-2</sup> ·h <sup>-0.5</sup> |
| Reagimi ndaj zjarrit:    | Euroclass A1                               |

### Udhëzimet e përdorimit

#### 1. Përgatitja e nënshtresës

Sipërfaqja duhet të jetë e pastër, pa pluhur, pa vaj, materiale të lira etj. Çfarëdo lloj plasaritje ose vrimë duhet të mbushet me materialet e përshtatshme.

Para aplikimit të DUROCRET-DECO në sipërfaqe thithëse, si në muraturë, beton, suva, bord gipsi duhet bërë astarim me astarin akrilik UNI-PRIMER ose FLEX-PRIMER në 1-2 shtresa, në varësi të thithjes të nënshtresës. DUROCRET-DECO aplikohet mbas 2-3 orësh, sipas kushteve të motit dhe mbas astari është tharë krejt.

Sipërfaqet jo thithëse si shtresat e vjetra të pllakave ose mozaiket, duhet të astarohen me astarin SUPERGRUND. DUROCRET-DECO mund të aplikohet mbas 24 orësh, dhe vetëm po të jetë tharë krejt astari.

#### 2. Përdorimi

##### Për mure

DUROCRET-DECO hidhet në ujë duke u trazuar, derisa të krijohet një përzierje në formën e kërkuar të punueshmërisë. Materiali aplikohet duke përdorur një mallë me dhëmbë 10 mm. Në sipërfaqja e "krehur" me DUROCRET-DECO vendoset rrjetë xhami me peshë 160 g/m<sup>2</sup>, e cila pastaj ngjeshet me anën e lëmuar të mallës duke krijuar një sipërfaqe të lëmuar.

Mbas 24 orësh, sipërfaqja e ngurtësuar e DUROCRET-DECO FLEX astarohet me astarin akrilik UNI-PRIMER ose FLEX-PRIMER.

Sa rrëshira është akoma e njomë (fresh on fresh), aplikohet DUROCRET-DECO ose DUROCRET-DECO FINISH në një shtresë të hollë (1-2 mm) në çfardo ngjyrë të dëshiruar për ta krijuar stilin e llaçit dekorues.

Për aplikime në mure të bërë nga pllaka prej gipsi ose pllaka çimentoje, është e nevojshme të shtoni ADIFLEX-B në DUROCRET-DECO në raportin 1-2 kg për çdo 25 kg për të përmirësuar vetitë e tij.

# DUROCRET-DECO

## Për dysheme

Shtoni 1-2 kg ADIFLEX-B në 25 kg DUROCRET-DECO për të përmirësuar vetitë e tij. Në këtë rast, pakësoni sasinë e ujit të përzierjes që nevojitet për të përfutur një përzierje me punueshmërinë e dëshiruar.

Në vend të DUROCRET-DECO, mund të përdorim edhe DUROCRET-DECO FLEX, llaç fleksibël i parapërzier, me bazë çimentoje i modifikuar me polimer, i përforcuar me fibra, për përfundimin e sipërfaqeve në dysheme dhe në mure.

2-3 ditë mbas plotësimit të aplikimit, dhe me kusht që sipërfaqja është tharë, mund të aplikohen llaqet mbrojtëse në mënyrën e mëposhtme.

## Ngjyrosja e DUROCRET-DECO

DUROCRET-DECO është në dispozicion në tri ngjyra të gatshme të përziera (e bardhë, gri, gri e lehtë). Mund të ngjyrosët gjithashtu edhe me pigmente inorganike me cilësi të lartë ISOMAT DECO-COLOR. Pigmentet ISOMAT DECO-COLOR janë në dispozicion në 10 ngjyra të ndryshme dhe mund të kombinohen duke mundësuar kështu një numër të pakufizuar ngjyrash.

Në mënyrë që të arrihet një përzierje më e mirë, pigmenti duhet të tretet në ujin e përzierjes, përpara se të hidhet llaçi në të.

Është gjithashtu e mundur të shtoni pigmentin pasi llaçi të jetë përzier me ujë, por në këtë rast, materiali duhet të përzihet plotësisht, në mënyrë që të arrihet ngjyrosja e njëtrajtshme e llaçit.

Në aplikimet në shkallë të gjerë, preferohet që fillimisht pigmenti të tretet në ujë.

Përveç kësaj, rekomandohet që llaçi që do të ngjyrosët të jetë i bardhë, në mënyrë që nuanca përfundimtare të përftohet më lehtë, veçanërisht nëse ngjyra e përzgjedhur është e çelur.

Në rast se kërkohen më shumë se 10 doza të 50 g për 25 kg DUROCRET-DECO, sygjerohet të lidheni me Departamentin e Mbështetjes Teknike të ISOMAT.

## Përdorimi i llaqeve

Llaçi dekorativ prej çimentoje mbohet me shtresën e llakut poliuretanik me bazë tretës VARNISH-PU 2K (gloss ose satin) ose llakut poliuretanik me bazë uji VARNISH-PU 2KW (satin-mat). Llaku me bazë uji është ideal për ambiente të brëndshme, hapësira me ajrosje të dobët, sepse është gati pa erë.

Llaqet VARNISH-PU 2K dhe VARNISH-PU 2KW shtrohen me furçë në dy shtresa. Stresa e dytë shtrohet 4-24 orë pas shtresës të parë, me kusht që ajo të jetë tharë.

Konsumi: 70-120 g/m<sup>2</sup> për shtresë.

Për shpërndarje më të mirë të llakut, sygjerohet që mbas zhytjes të rylit në llak, të shtrydhet në govatë dhe pastaj të përdoret për lyerjen e sipërfaqes.

VARNISH-PU 2K (gloss ose satin) në përgjithësi e errëson sipërfaqen. Në rast që kjo nuk është e dëshirueshme, rekomandohet kombinimi i dy llaqeve në mënyrën e mëposhtme:

Fillimisht, aplikohet llaku akrilik me bazë uji VS-W (i holluar me ujë 1:1) në një shtresë me konsum 150-200 ml/m<sup>2</sup>.

Mbas 24 orësh, aplikohet llaku poliuretanik VARNISH-PU 2K (gloss ose satin) në dy shtresa. Shtresa e dytë aplikohet 4-24 orë mbas të parës, me konditën që ajo është tharë.

Përdorimi i VS-W ndihmon që llaçi prej çimento të mos errësohet nga VARNISH-PU 2K. Gjithashtu, përdorimi i VS-W mund të përmirësojë dukshëm pamjen përfundimtare të sipërfaqes mikroçimentoze kur ai përdoret i holluar me ujë në një raport prej 1: 1, në një shtresë të caktuar, përpara aplikimit të lustrës me bazë uji VARNISH PU-2KW.

## Konsumi

Rreth 15 kg/m<sup>2</sup>/cm të trashësisë së shtresës.

## Amballazhimi

Thasë 25 kg.

## Magazinimi

Të paktën 12 muaj nga data e prodhimit në thasë të mbyllur, në vende të mbrojtura nga lagështia dhe ngrica.

# DUROCRET-DECO

## Shënime

- Temperatura gjatë aplikimit duhet të jetë ndërmjet +5°C dhe +30°C.
- Gjatë verës rekomandohet të meren masat e nevojshme për të mbrojtur DUROCRET-DECO nga humbja e ujit si rezultat i temperaturave të larta.
- Produkti përmban çimento dhe reagon si alkaline me ujin, kështu që klasifikohet si irritues.
- Shikoni rreziqet e përdorimit dhe këshillat për sigurinë që janë të shkruara mbi thes.



### ISOMAT S.A.

17<sup>th</sup> km Thessaloniki – Ag. Athanasios  
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece

12

EN 1504-3

Concrete repair product for non structural repair  
PCC mortar (based on hydraulic cement,  
polymer modified)

DoP No.: DUROCRET-DECO/1200-02

Compressive strength: class R2

Chloride ion content:  $\leq 0.05\%$

Adhesion:  $\geq 0.8$  MPa

Thermal compatibility part 1:  $\geq 0.8$  MPa

Capillary absorption:  $\leq 0.5 \text{ kg} \cdot \text{m}^{-2} \cdot \text{h}^{-0.5}$

Dangerous substances: comply with 5.4

Reaction to fire: Euroclass A1

### ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

#### ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

Kilometri i 17të i Autostradës Selanik-Aj. Athanasiu 570 03

Tel. : +30 2310 576 002, Fax: +30 2310 576 029

[www.isomat.al](http://www.isomat.al) e-mail: [support@isomat.eu](mailto:support@isomat.eu)